



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERJISË
DHE INDUSTRIË
MINISTRI

URDHËR

NR. 121, DATË 08.05. 2015

**PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË “RREGULLOREN PËR PROCEDURAT
E MIRATIMIT TË MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE DHE LICENCE
MARREVESHJEVE, SI DHE AFATET PERKATESE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit Nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar

URDHËROJ:

Në “Rregulloren për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licence marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si me poshtë:

Në mbështetje të pikës f, të nenit 9 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Per hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), të ndryshuar, hartohet Rregullorja e përcaktimit të procedurave të miratimit të marrëveshjes hidrokarbure, licencë marrëveshjes si dhe afateve përkatëse për miratimin e tyre.

2. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

Procedura për përgatitjen dhe miratimin e një Marrëveshje Hidrokarbure, nga MEI, AKBN dhe Albpetrol, sipas zonave që kanë në administrim si dhe afatet kohore të miratimit të tyre janë si më poshtë:

3. Nën-pika (a), e pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

MEI dhe AKBN të publikojnë në faqen e tyre të internetit hartën me blloqet e lira të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe formularin e aplikimit. Në formatin e aplikimit duhet të përfshihet edhe afati i dorëzimit të aplikimeve për blloqet e lira.

Subjektet e interesuara paraqesin pranë MEI, AKBN ose Albpetrol (në rastin e zonave që administrohen nga Albpetrol) një aplikim për të hyrë në Marrëveshje Hidrokarbure. Në rast aplikimi në MEI, ai dërgohet për shqyrtim në AKBN brenda 10 ditëve.

AKBN e shqyrtton aplikimin sipas procedurës se mëposhtme:

- Në rastin kur në AKBN ose Albpetrol ka aplikim nga një subjekt i vetëm për një bllok ose vendburim të lirë, AKBN ose Albpetrol sipas rasti, brenda 10 ditëve nga marrja e aplikimit, i paraqet Ministrisë se Energjisë dhe Industrisë (MEI) dokumentacionin e nevojshëm dhe kërkesën për miratimin e fillimit të negociimeve. MEI jep aprovimin ose jo për fillimin e negociatave brenda 7 ditëve nga marrja e propozimit nga AKBN ose Albpetrol.

- Në rast se, ka me shume se një aplikim për një bllok ose vendburim të lirë, AKBN ose Albpetrol sipas rasti, do të përcjellin në MEI dokumentacionin e shoqërive aplikuese dhe vlerësimin e AKBN ose Albpetrol bazuar në kapacitetin teknik, financiar si dhe termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure. Mbi këtë dokumentacion të paraqitur, MEI miraton ose jo shoqërinë fituese.

4. Paragrafi i pare, i nënpikës b, të pikës 2, ndryshohet si me poshtë:

Në rast miratimi nga MEI të kërkesës se AKBN ose Albpetrol, përfaqësuesit e AKBN ose Albpetrol fillojnë negociatat me subjektin e përzgjedhur fitues nga MEI për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, në baze të aplikimit të paraqitur nga subjekti fitues. Me urdhër të Ministrit, në grupin negociator do të caktohen përfaqësues nga MEI ose eksperte të jashtëm. Pasi palët bien dakord, dokumenti nënshkruhet nga të dy palët dhe i përcillet MEI për miratim. Gjate procesit të negociatave do të mbahen minutat e takimeve.

5. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve, AKBN dhe Albpetrol Sh.A..

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI